



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9616 Prot.

Vlorë, më 19.06. 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

**“PËR DISA KORRIGJIME DHE SAKTËSIME NË VKB NR.31 DATË 02.04.2020
“PËR MIRATIMIN E KODIT TË SJELLJES DHE RREGULLAVE PËR
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE TË ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a neni 47, neni 49 dhe neni 54 pika k, në Ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 112, në Ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave” i ndryshuar, si dhe në relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.06.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë korrigjimet dhe saktësimet në Rregulloren “Kodi i Sjelljes dhe Konfliktit të Interesave të Këshilltarit Bashkiak” miratuar me VKB nr. 31 datë 02.04.2020 si më poshte:
 - a. Në emërtimin(titullin) e Rregullores togfjalëshi “Rregullore, Kodi i Sjelljes dhe i Parandalimit të Konfliktit të Interesave të Këshilltarit Bashkiak” të formulohet në këtë mënyrë: “Rregullore për Kodin e Sjelljes dhe i Parandalimit të Konfliktit të Interesave të Anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë”
 - b. Në nenin 5 pika 10, togfjalëshi “Këshilltari duhet të njoftojë Sekretarin për dhurata me vlerë më të madhe se ajo e specifikuar nga Këshilli(xxxxxxxxx lekë) si dhe burimin e tyre” të formulohet në këtë mënyrë: “Këshilltari duhet

të njoftojë Sekretariatën për dhurata me vlerë më të madhe se 10.000(dhjetëmijë) lekë si dhe burimi i tyre”

- c. Në nenin 7 pika 1 togfjalëshi “ Autoriteti që merret me thyerjet e kodit është komisioni i etikës të standarteve dhe apelimeve i cili përbëhet nga -----Këshilltarë” të formulohet në këtë mënyrë: “Autoritetit që merret me thyerjet e kodit të sjelljes është Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve i cili përbëhet nga 7 Këshilltarë nga të cilët 4 anëtarë i takojnë shumicës në Këshill dhe 3 anëtarë i takojnë pakicës në Këshill”
2. Ndryshimet sipas këtij vendimi pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë bëhen pjesë e rregullores “Për Kodin e Sjelljes dhe i Parandalimit të Konfliktit të Interesave të Anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Sekretari i Këshillit të Bashkisë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3616 Prot.

Vlorë, më 19.06. 2024

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN

**“PËR DISA KORRIGJIME DHE SAKTËSIME NË VKB NR.31 DATË 02.04.2020
“PËR MIRATIMIN E KODIT TË SJELLJES DHE RREGULLAVE PËR
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE TË ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË”**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Anëtarë të Këshillit të Bashkisë

Projektvendimi “Për disa Korrigjime dhe Saktësime në VKB Nr.31 Datë 02.04.2020 “Për Miratimin e Kodit të Sjelljes dhe Rregullave për Parandalimin e Konfliktit të Interesave të Anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë” që ju paraqesim për miratim lidhet me disa korrigjime ose saktësime të cilat në vlerësimin tonë janë të domosdoshme.

Kjo pasi rregullorja e miratuar me VKB nr.31 datë 02.04.2020 rezulton që është miratuar sipas projektit të propozuar nga projekti “Bashki të Forta” por pa ju referuar saktësisht Këshillit të Bashkisë Vlorë. Kjo vërehet në emërtimin ose titullin e rregullores si dhe në nenin 5 pika 10 ku nuk është përcaktuar shuma në lekë që duhet deklaruar nga Këshilltarët. Kjo e bën të domosdoshme që në titullin e rregullores të përcaktohet Këshilli i Bashkisë Vlorë si dhe në pikën 10 të nenit 5 të përcaktohet shuma për të cilën propozojmë të jetë 10.000(dhjetëmijë) lekë. Gjithashtu në nenin 7 të rregullores nuk është plotësuar numri i anëtarëve dhe përbërja e komisionit të etikës, gjë që është e domosdoshme gjatë procedurave vendimmarrëse të tij.

Duke qënë se në rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë” në nenin 43 është parashikuar që numri i anëtarëve të Komisionit të Etikës është 7 anëtarë sikurse dhe në të gjitha Komisionet e Përherëshme të Këshillit të Bashkisë propozojmë që edhe në rregulloren të cilës i referohet ky projektvendim, numri i anëtarëve të Komisioni të jetë 7 Këshilltarë.

Propozojmë gjithashtu që 4 anëtarë ti përkasin shumicës në Këshill dhe 3 anëtarë ti përkasin pakicës në Këshill.

Nga sa më lartë kërkojmë nga Këshilli të miratojë këtë projektvendim për të evituar ndonjë problematikë gjatë procedurave për të cilat kërkohet zbatimi i rregullores “Për Miratimin e Kodit të Sjelljes dhe Rregullave për Parandalimin e Konfliktit të Interesave të Anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë” si dhe funksionimit të komisionit përkatës.

Ju faleminderit

KRYETAR
Elpiniq Merkur

